



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 6/2 Prot.

Tiranë, më 07. 02. 2022

V E N D I M

Nr. 33 , Datë 07. 02. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 19 Regj., datë 31.01.2022, të shtetases N. Sh, kundër Qendrës Balneare pranë Bashkisë Dibër, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “*bindjeve politike*”, “*moshës*” dhe “*gjendjes shëndetësore*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, N. Sh, ka filluar punë në datën 25.06.1990, pranë Qendrës Balneare Peshkopi. Referuar kronologjisë kohore, ankuesja, nga data 25.06.1990 deri me datë 16.03.2004 ka punuar në pozicionin “Punëtore banje” dhe nga data 16.03.2004 deri me datë 19.09.2019 ka punuar në pozicionin “Arkëtare”. Me Vendimin nr. 110, datë 19.09.2019 “Për lëvizje në detyrë” është vendosur që ajo të kalojë përkohësisht në pozicionin e “Specialistes së Ndhmës Ekonomike” në

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Njësinë Administrative Melan, në vend të Xh. M, deri në përfundimin e raportit mjekësor të kësaj të fundit.

Ankuesja nga data 20.09.2019 deri me datë 30.09.2019, ka qenë me paaftësi të përkohshme në punë, fakt i provuar nga raportet mjekësore të paaftësisë për punë, adminstruar në dosje në cilësi prove.

Në datën 08.10.2019 ankuesja është njoftuar nga punëdhënësi me anë të shërbimit postar për të biseduar lidhur me ecurinë e marrëdhënies së punës. *(Njoftim i cili citonte që takimi zhvillohej me datë 07.10.2019).*

Ankuesja është paraqitur në vendin e punës pas mbarimit të raportit të paaftësisë së përkohshme për punë, dhe po atë ditë është njohur me Vendimin nr. 110, datë 19.09.2019, të transferimit të saj të përkohshëm, në Njësinë Administrative Melan.

Me Vendimin nr. 12, datë 14.10.2019 “Për lirim nga detyra”, Bashkia Dibër ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës me ankuesen N. Sh, me motivacionin se: *“N. Sh lirohet nga detyra e “Specialistes së Ndhmës Ekonomike pranë Njësisë Administrative Melan”, sepse nuk është paraqitur në vendin e punës për më shumë se 7 ditë rresht, duke shkelur detyrimet kontraktuale në mënyrë të përsëritur dhe pa paraqitur asnjë dokument justifikues për mosprezencën e saj”*.

Ankuesja shprehet se ka kundërshtuar verbalisht transferimin e saj, tek drejtuesi i Qendrës Balneare ku ushtronte detyrën dhe se e kishte të pamundur për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore, të shkonte në Njësinë Administrative Melan, pasi ishte në distancë më të largët nga vendbanimi i saj krahasuar me vendin aktual të punës.

Ajo ka pretenduar se është diskriminuar nga punëdhënësi pasi në vend të saj është emëruar një punonjëse në moshë më të re, krahasuar me të.

Lidhur me largimin nga puna, ankuesja ka pretenduar diskriminimin dhe për shkak të bindjeve politike. Ajo shprehet se, gjatë 30 viteve të saj të punës ka punuar me drejtues me bindje të majta dhe të djathta, dhe se asaj i është kërkuar verbalisht nga ana e drejtorit të Qendrës Balneare Peshkopi të marrë pjesë në votimin e datës 30 Qershor 2019. Megjithëse ajo ka votuar me datë 30 qershor 2019, sërish u largua nga puna duke u zëvendësuar me militantë të Partisë Socialiste. N. Sh shprehet se megjithëse ajo nuk ka patur asnjëherë një dokument anëtarësie në ndonjë parti politike, bindjet e saj politike janë të djathta.

Ankuesja ka pretenduar se gjatë 30 viteve të saj të punës nuk ka marrë asnjë vërejtje nga eprorët apo punëdhënësi dhe se ka punuar me përkushtim e ndershmëri dhe se, trajtimi i saj nga punëdhënësi duke zgjidhur marrëdhënien e punës me të, është i padrejtë dhe tendencioz, i motivuar vetëm nga shkaqet që ka cituar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e Bashkisë Dibër dhe rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

- Subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e punëdhënësit/Bashkisë Dibër, që me datë 30.09.2019, ditën kur është paraqitur në punë, pas përfundimit të raportit të paaftësisë së përkohshme në punë (*raporti mjekësor është dhënë nga data 20.09.2019-30.09.2019*) dhe i është njoftuar Vendimi nr. 110, datë 19.09.2019, të transferimit të saj të përkohshëm, në Njësinë Administrative Melan.
- Fakti i marrjes dijeni të këtij vendimi dhe kundërshtimit të ankueses për të pranuar këtë transferim, është konsideruar me të drejtë prej saj si ndërprerje e marrëdhënieve të punës, fakt për të cilin është shprehur edhe gjykata (*Referuar Vendimit nr. 253, datë 01.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër*), e cila ka konsideruar si datë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës datën e transferimit, dhe jo datën 14.10.2019 të lirimit të saj nga detyra. (*Vendimi nr. 12, datë 14.10.2019 “Për lirimin nga detyra të N. Sh”, nëpërmjet të cilit Bashkia Dibër ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës me ankuesen, me motivacionin se, ajo nuk është paraqitur në vendin e punës për më shumë se 7 ditë rresht, duke shkelur detyrimet kontraktuale në mënyrë të përsëritur dhe pa paraqitur asnjë dokument justifikues për mosprezencën e saj*).
- Nga aktet shkresore të depozituara nga ankuesja³, rezulton se, pretendimet për largim të paligjshëm dhe të padrejtë nga puna, N. Sh i ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor. Në arsyetimin dhe argumentimin e bërë nga gjykata, rezulton se ajo ka pranuar se momenti i zgjidhjes së marrëdhënies së punës mes ankueses, në cilësinë e punëmarrëses dhe Bashkisë Dibër, në cilësinë e punëdhënësit, konsiderohet momenti i transferimit të saj,

³ Vendimi nr. 253, datë 01.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

pra data 19.09.2019, fakt për të cilin ajo ka marrë dijëni me datë 30.09.2019, kur është paraqitur në vendin e punës.

- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesja ka marrë dijëni për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës (fakt për të cilin dhe pretendon diskriminim), që në datë 30.09.2019. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 31.01.2022,** pra më vonë se dy vite nga marrja dijëni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese”, ankesa e shtetases N. Sh, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se LMD, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës”.

Nga ana tjetër, LMD, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: ”Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34⁴ të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijëni për këtë sjellje”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj⁵, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

⁴ “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.

⁵ Neni 36 i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar: “Procedura para gjykatës”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së N. Sh, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Moshë, gjendje shëndetësore, bindje politike

Lloji i vendimit: Mospranim